



**Universiteti "Ukshin Hoti"**  
**University "Ukshin Hoti"**  
**Prizren**

**KËSHILLI DREJTUES**

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Universitet Prizrena <b>"UKSHIN HOTI"</b>	
Pranuar më dt.	16.06.2023
Zyra e pranimit	Nr. i protokolit
308	01-365

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+383 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

**Kryesuesi i Këshillit Drejtues**  
**Prof. asoc. dr. Arif Murrja**

Nr. i ref. \_\_\_\_\_

Prizren, më 16.06.2023

Në bazë të kompetencave të Këshillit Drejtues të cilat janë konform Ligjit Nr. 04/L-37 dt. 29.08.2011, neni 18, paragrafi 1 si dhe dispozitave të nenit 17, paragrafi 1 dhe 2 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren (UUHP), Nr. 04-V-621 dt. 30 maj 2013 si dhe në mbështetje të nenit 11 të Rregullores për zgjedhjet e studentëve në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren, Këshilli Drejtues i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 16.06.2023, miratoi këtë:

**VENDIM PËR MIRATIMIN E DINAMIKËS SË PROCESIT TË ZGJEDHJEVE  
STUDENTORE NË UNIVERSITETIN "UKSHIN HOTI" NË PRIZREN**

- 1) Dinamika e procesit zgjedhor për zgjedhjet studentore të Parlamentit të Studentëve dhe Këshillet e Studentëve në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren është bazuar në vendimin mbi shpalljen e zgjedhjeve studentore, konform Ligjit Nr. 04/L-37 të dt. 29.08.2011, Statutit të Universitetit Nr. 04-V-621 dt. 30 maj 2013 si dhe Rregullores Nr. 01-34 dt. 09.02.2018 dhe plotësim ndryshimit të saj Nr. 01-150, dt. 11.05.2021, si dhe plotësim ndryshim të saj, dt. 16.06.2023 për zgjedhjet e studentëve në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren.
- 2) Obligohen të gjitha organet udhëheqëse të Universitetit duke përfshirë edhe Komisionin Zgjedhor që t'i përmbahen me përpikëri të gjitha afateve të përcaktuara në këtë dinamikë zgjedhore.
- 3) Për zbatimin e kësaj dinamike përgjegjësinë e organit mbikqyrës e ka Këshilli Drejtues.

**Shpallja e vendimit për fillimin e procesit zgjedhor më 16.06.2023**

Nr.	PËRMBAJTA	DATA
1.	Publikimi i vendimit për shpalljen e zgjedhjeve studentore dhe materialeve tjera	16.06.2023
2.	Konstituimi i KQZ (Komisioni Qendror i Zgjedhjeve)	20.06.2023
3.	Regjistrimi i Organizatave Studentore në Sekretarinë e Universitetit dhe KQZ	21.06 – 26.06.2023
4.	Certifikimi i Organizatave Studentore nga KQZ	26.06.2023
5.	Tërheqja e shortit për numrat e secilës Organizatë studentore të certifikuar nga KQZ që marrin pjesë në zgjedhje	26.06.2023
6.	Fushata zgjedhore e Organizatave Studentore	27.06 – 07.07.2023
7.	Shpallja e listës preliminare të studentëve me të drejtë vote, verifikimi dhe miratimi i tyre në KQZ	23.06.2023
8.	Periodha e ankesave ndaj listës preliminare të miratuar nga KQZ	23.06 – 02.07.2023
9.	Shpallja e listës përfundimtare të studentëve me të drejtë vote nga	03.07.2023

	KQZ	
10.	Dorëzimi i listave të kandidatëve për PS <sup>1</sup> dhe KS <sup>2</sup>	26.06 – 30.06.2023
11.	Certifikimi i listave të kandidatëve për PS <sup>3</sup> dhe KS <sup>4</sup>	03.07.2023
12.	Përgatitja e procesit të votimit elektronik, procesverbaleve dhe procedurave tjera, në bashkëpunim me zyrën e IT-së dhe përfaqësuesit e autorizuar të SMU-së.	19.06 – 08.07.2023
13.	Dita e mbajtës së zgjedhjeve	10.07.2023
14.	Shpallja e rezultateve preliminare	10.07.2023
15.	Shpallja e rezultateve përfundimtare	17.07.2023
16.	Periudha e ankesave	Sipas rregullores

**Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e Kryesuesit të Këshillit Drejtues.**

**Vendimi i dërgohet:**

- MASHTI-t
- Këshillit Drejtues
- Menaxhmentit
- Sekretarit të Përgjithshëm
- Parlamentit të Studentëve dhe
- Arkivit

  
 Prof. Asoc. Dr. Arben MULLAJ  
 Kryesues i Këshillit Drejtues



<sup>1</sup> Parlamenti i Studentëve

<sup>2</sup> Këshilli i Studentëve

<sup>3</sup> Parlamenti i Studentëve

<sup>4</sup> Këshilli i Studentëve